



Pranuar / Datozuar Prilapen / Prilapen Received / Received	26.09.2023	3	viti god Year
Organ / Shkëmbim Organ / Shkëmbim Org / Org	Si Prot Si Prot Prot No	Shtesa Përngj Appendix	Sasia Këmbim Quantity
SKRIBACI	3837/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.567/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në lidhje me ankesën A.nr.567/2023 të datës 27.03.2023 të parashtruar nga ankuesja, kundër organit të punësimit/Komuna e Drenasit, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.567/2023 e datës 27.03.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile e punësuar në Komunën e Drenasit, më datë 27.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kategorizimin e pozitës se saj të punës në Kategorinë Profesionale 3.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 30.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Drenasit, ndërsa me datë 13.04.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga analizimi i shpresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Aktin e Emërimit të datës 01.07.2011, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtar i Gjendjes Civile" në Drejtorin e Administratës së Përgjithshme në Komunën e Drenasit, niveli administrativ.

Ankuesja, me datë 27.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me datë 05.02.2023, ankuesja është kategorizuar në Kategorinë Profesionale 3, përkundër se e njëjta pretendon se i plotëson të gjitha kushtet ligjore për Kategorinë Profesionale 2, bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërsa nga përmbajtja e shkresave të lëndës kolegji i këshillit ka gjetur se ankuesja përkatësisht disa zyrtarë me pozitë të njëjtë i kanë adresuar një ankesë më datë 02.03.2023 Zyres së Burimeve Njerëzore të Komunës së Drenasit ,për rivlerësim të kategorizimit të klasës që lidhet edhe me pretendimin e ankueses, ndërsa poashtu e njëjta më datë 17.03.2023 nga Zyra e Burimeve Njerëzore të Komunës së Drenasit ka pranuar një përgjigje ndaj ankesës, përmes së cilës shkresë njoftohet se janë ndërmarrë veprimet konformë ligjit të pagave përkatësisht kërkesës së Departamentit të Menaxhimit të Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe se janë në pritje të përgjigjes në lidhje me këto kërkesa që janë objekt i kësaj ankese, ndërsa ankesa në këshill është adresuar më datë 27.03.2023, andaj mbi këtë bazë ankesa është e palejuar në këshill për faktin se ende pa kaluar afati ligjor i përgjigjes zyrtare nga DMZP-ja ankuesja ka adresuar ankesë në këshill.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, përkatësisht Komuna e Drenasit, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficientëve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjëshit deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë profesionale 1 është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në at që u tha më lartë, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.567/2023, datë 25/04/2023

**Vjollca Sinani**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së